



**AUTORITETI PORTUAL DURRËS**  
**Divizioni i Standarteve, Shëndetit dhe Emergjencave**  
**Njësia e Mjedisit**

**Prezantim:**

Ne vitin 1993 Shqipëria u bë anetare e IMO - Organizata Ndërkombëtare Detare, e cila është një agjensi e specializuar e Kombeve të Bashkuara me përgjegjësinë për sigurinë e transportit detar dhe parandalimin e ndotjeve detare nga anijet.

Instrumentat e IMO -s, Konventat, Kodet dhe Protokollet me amendimet përkatëse, trajtojnë të gjitha aspektet e transportit detar global – përfshirë projektimin, konstruksionin, pajisjet, ekuipazhin/personelin, operacionet dhe depozitimin – për të siguruar që transporti detar të jetë i sigurt, ekologjik dhe eficient.

Për këtë qëllim, Parlamenti Shqiptar ka ratifikuar një sërë Konventash në fushën e mbrojtjes së mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi.

Në kushtet kur Shqipëria aspiron t'i bashkohet familjes së madhe të Komunitetit Europian, Legjislacioni Shqiptar ka reflektuar përfaqesën e Direktivave Europiane edhe në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Ankesi I, bashkëlidhur paraqet një panoramë komplekse të legjislacionit mjedisor, me qëllim që të krijojmë kuadrin për kërkesat specifike të implementimit të kontratës së shërbimit: Pastrimi i akuariumit të Autoritetit Portual Durrës.

Kërkesat Specifike për shërbimin e pastrimit të akuariumit, do të jenë pjesë integrale e kërkesave të legjislacionit të pasqyruar në Aneksin I.

## **I. PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT**

Autoriteti Portual Durrës, për të garantuar kërkesat ligjore si dhe standartet ndërkombëtare, si port kryesor në Shqipëri, kërkon nëpërmjet procedurës së tenderit, përzgjedhjen e një operatori të specializuar, që do të ofrojë shërbimin e pastrimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të akuariumit të A.P.D -së.

Realizimi i këtij shërbimi ka për qëllim përbushjen e kërkesave të menaxhimit mjedisor në port për të siguruar një ekuilibër ekologjik nga impaktet mjedisore, gjeneruar gjatë aplikimit të projekteve si dhe veprimtarisë operacionale në port.

Shërbimi do të kryhet çdo ditë, pra 365 ditë të vitit. Kontrata për realizimin e shërbimit është për një periudhë 3 vjecare. **Pagesa do të bëhet për ditë pune. Detyra parësore e kompanisë është pastrimi nga të gjitha mbetjet (të ngurta dhe vajore) dhe monitorimi në vazhdimësi i akuatoriumit. Detyra e rëndësishme dhe prioritare duke mos u kufizuar në kohë është përgjigja ndaj emergjencave detare të shkallës së parë.**

Çdo ditë, operatorët e Kompanisë do të fillojnë punën në orën 07:00 për stinën e verës dhe në orën 7:30 për stinën e dimrit. Puna fillon me monitorimin e të gjithë akuariumit, duke evidentuar zonat e ndotura nga mbetjet e ngurta ose mbetjet vajore.

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 9 punonjës.

- Për punën në anijen teknologjike me kosha - 3 persona, ku 1 person kujdeset për drejtimin e mjetit dhe 2 personat e tjerë do të angazhohen për grumbullimin në bord të mjeteve të ngurta nga akuariumi në bordin e anijes.
- Për marrjen e mbetjeve të ngurta nga kalata apo koshat e depozitimit provizor dhe transportin e tyre në Vend Depozitimit të caktuar nga Bashkia e Qytetit Durrës, në Zonën e përcaktuar nga Bashkia - 1 person;
- Në rast emergjence, bumseri do të aktivizohet duke u çmbështjellë për rrethimin e zonës së ndotur në akuarium - 2 persona
- Për hapjen e bumserit në det në rast emergjence duhet edhe një drejtues për anijen e dytë që do të bëjë tërheqjen e bumserit deri në hapjen përfundimtare për rrethimin e zonës së ndotur - 1 person
- Për drejtimin e anijes me tanker/depozitë për të marrë mbetjet vajore në akuarium apo dhe në radë kur kemi një incident detar/emergjencë - 1 person;
- Për transportin e mbetjeve vajore për në Impiantin e Riciklimit të licensuar për këtë qëllim - 1 person;
- Personat që do të punojnë në anije (**5 persona**), në përputhje me detyrimet e parashikuara në Kodin Detar, **duhet të jenë të pajisur me Kartën e Detarit.**
- Personat që do të bëjnë transportin e mbetjeve (2 persona), duhet të kenë patentë për drejtim mjeti.

**Kontraktuesi, për kryerjen e shërbimit, do të ketë në dispozicion pa ndërprerje, këto pajisje:**

1. Materiale antindotëse si absorbentë, dispersantë/shpërbërës, të cilat janë materiale konsumi që do të blihen në mënyrë periodike, duke garantuar mall gjendje në cdo kohë.
2. Pompa për sprucim të materialit shpërbërës (dispersant) - copë 2
3. Kosha për grumbullimin provizor të mbetjeve të ngurta të nxjerra nga akuariumi, me kapacitet 1.1 m<sup>3</sup>, me logon e Kompanisë/ Kontraktorit - 4 copë

Kompania duhet të dëshmojë/Formular Vetdeklarimi se disponon të gjitha mjetet e kërkuara për realizimin me sukses të shërbimit sipas detyrimeve kontraktuale. Kompania duhet të paraqesë dëshminë e pronësisë ose kontratën e qerasë së mjeteve, për realizimin e shërbimit.

**Mbetjet e ngurta mund të vijnë nga këto burime:**

- Mbetje të gjeneruara nga derdhjet e lumenjve si barëra, trungje etj të cilat shkarkojnë në det dhe janë shumë evidente veçanërisht në stinën e dimrit, kur për shkak të rrymave detare ato arrijnë deri në akuariumin e Autoritetit Portual.
- Mbetje të gjeneruara nga zona e peshkimit si arka peshkimi, rrjeta peshkimit, etj
- Mbetje të gjeneruara nga anijet dhe tragetet si shishe plastike etj

#### **Mbetjet vajore mund të vijnë nga këto burime:**

- Megjithëse anijet dhe tragetet, në përputhje me kërkesat e Konventës MARPOL 73/78, duhet të dorëzojnë mbetjet vajore tek kompanitë e licensuara që kanë fasilitetet marrëse për mbetjet, përsëri ka raste sporadike të derdhjes së tyre në akuarium, për të shmangur pagesën për dorëzimin e tyre.
- Përveç rasteve të derdhjes vajore në mënyrë të vullnetshme, ka dhe raste të incidenteve detare me derdhje vajore/hidrokarbure në akuarium, si për shkak të rënies së një anije në cekëtinë, mbytyes së anijes për shkaqe të ndryshme, përplasjes së dy anijeve, apo nga pakujdesia në procesin e dorëzimit të tyre tek firma ricikluese.

#### **Pastrimi i akuariumit, 67 ha**

##### Pastrimi i akuariumit nga mbetjet e ngurta

- Mbledhja e mbetjeve të ngurta nga akuariumi me ane të anijes teknologjike me kosha portative.
- Depozitimi në katër pikat provizore në kalate, të ambalazhuar me thasë plastmasi ose rifuxho në kalatë ku është shtruar plastmas.
- Mbetjet e ngurta duhet të sistemohen në thasë plastmasi në bordin e anijes, ose në rast se do të duhet të mblidhen në kalatë, paraprakisht të shtrohet plastmas, në mënyrë që të mos ndotet kalata.
- Kontraktori duhet të vendosë koshat me kapacitet 1.1 m<sup>3</sup> për depozitimin provizor të mbetjeve të ngurta të nxjerra nga akuariumi. Koshat duhet të kenë logon e kompanisë dhe do të vendosen në pikat pranë Kalates 0, Kalatës 4, Kalatën e Trageteve dhe në Zonën Lindore. Koshat dhe pikat e grumbullimit provizor duhet të dezinfektohen me pluhur hipoklorit kalciumi (klor).
- Akt-Marrëveshje e lidhur midis Operatorit ekonomik dhe një Landfilli të miratuar dhe licensuar për depozitimin e mbetjeve urbane të ngurta jo të rrezikshme.

##### Pastrimi i akuariumit nga mbetjet vajore/hidrokarburet

- Pastrimi me absorbent (jasteke thithës, litarë thithës, dispersante, letra thithëse etj) sipas rastit të sasisë së ndotjes.
  - Mbledhja e derdhjeve vajore me anë të pompave thithëse ose oil-skimer dhe depozitimi në tanker.
  - Evadimi i mbetjeve vajore në impiantin e riciklimit.
- a) Përsa i përket pastrimit të akuariumit nga mbetjet e lëngshme kur ato janë **në një sasi të vogël**, kontraktori duhet të përdorë metodat e mëposhtme:
- Pastrimin e akuariumit nga derdhjet vajore nëpërmjet dispersantit (shpërbërës i vajrave dhe karburanteve) ose me anë të thithësve të ndryshëm (absorbent), të cilët janë në formë jasteku thithës, batanije thithëse, ose bumser thithës në formë litari, që bën edhe rrethimin e

zonës së ndotur. Këto absorbente, pas përdorimit, do të grumbullohen në kontenierë të veçantë dhe do të trajtohen në zonën e riciklimit.

- Kontraktori duhet të marrë masa për blerjen e mjeteve antindotëse të cilat janë materiale konsumi si dispersantë, absorbentë etj.
- b) Kur në akuarium kemi mbetje vajore **në sasi të konsiderueshme**, kjo për shkak të një incidenti detar nga mbytja e ndonjë anije, përplasja e anijeve për shkak të kushteve të këqija të motit, apo nga hedhjet në mënyre të vullnetshme nga anije të ndryshme, kompania private do të angazhojë punonjësit e saj në operacionin e pastrimit, në përputhje me Planin e Kontigjencës nga Derdhjet Vajore.

## **Roli në rast të emergjencës nga një incident me ndotje vajore/hidrokarbure të akuariumit**

### **Baza ligjore**

- ✓ Ligji Nr 9130, Datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, neni 20, neni 40 - pika 4/a;
- ✓ V.K.M. Nr 596, Datë 10.09.2004 “Për miratimin e Statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe riorganizimin e tij”, neni 14;
- ✓ Ligji Nr 8756, Datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile” i ndryshuar, miratuar me V.K.M. Nr 835, Datë 03.12.2004;
- ✓ Ligji Nr 152/2015, Datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;
- ✓ Ligji Nr. 168/2013 “Për sigurinë në anije dhe në porte”;
- ✓ V.K.M. Nr. 209, Datë 09.04.2014: Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Sigurisë në anije dhe portet e hapura të Republikës së Shqipërisë”;
- ✓ Urdhër i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 85, Datë 11.06.2015: Për miratimin e Rregullores “Për forcimin e Sigurisë në anije dhe portet e hapura të Republikës së Shqipërisë”;
- ✓ V.K.M. Nr. 480, Datë 25.07.2012 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave për Reagimin ndaj Ndotjeve Detare në Republikën e Shqipërisë”;
- ✓ Urdhërit të Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të A.P.D -së Nr 352, Datë 28.01.2016, “Mbi Komitetin e Emergjencave Civile në Portin e Durrësit”;
- ✓ V.K.M. Nr 965, Datë 02.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave”;
- ✓ Urdhër i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Nr 171, Datë 29.12.2015 "Për ngritjen dhe funksionimin e Zyrës së Informacionit për Menaxhimin e Emergjencave e Krizave dhe drejtimin e saj”;

### **Qëllimi dhe fusha e veprimit**

Qëllimi i Planit të Emergjencës është:

- Të sigurojë strukturën e kontrollit emergjent dhe drejtimet që do të parandalojnë dëmtimin për punonjësit, qeramarrësit, kontraktorët dhe vizitorët dhe në raste ekstreme personat fqinjë dhe banesat. Procedurat gjithashtu do të ndihmojnë për të minimizuar dëmtimet për pajisjet dhe instalimet.
  - Të sigurojë minimizimin e ndikimit të ndonjë incidenti dhe të ulë probabilitetin e shkallëzimit të situatës emergjente, duke vënë në përdorim një përgjigje të planifikuar, duke zbatuar edhe një teknikë të përshtatshme në vendin e ngjarjes.

## **Fusha e veprimit**

Plani Portual Emergjent specifikon udhëzimet që duhen ndjekur nga personeli i zonave portuale në rast se një emergjencë ndodh në territorin ose në ujrat që janë në juridiksionin e zonave portuale.

Emergjencia ndodh në ndikimin e një sërë rrethanave të ndryshme, prandaj është e pavolitshme të formulohet një plan që do t'u përgjigjet të gjitha situatave.

Per kete arsye, veprimi që do të ndërmerret në një situatë të dhënë dhe personi i parë në vendin e ngjarjes do të jenë parësor dhe nuk është e nevojshme si rregull që t'i përmbahemi Planit.

Në rast se do të ndodh një emergjencë, do të ndiqen principet e specifikuara në Plan dhe detajet kryesore të situatës duhen raportuar tek kordinatori i emergjencave të zonave portuale dhe pastaj do të njoftohet Ministria e Transportit. Menjëherë do të tregohet natyra e aksidentit dhe kordinatori i emergjencave do të marrë kontrollin e situatës në zonat portuale. Kjo, në rast se emergjenca do të shtrihet në një periudhë të konsiderueshme kohe.

Gjithë personeli i zonave portuale duhet të jetë i trajnuar në rolet dhe përgjegjësitë e tyre sipas Planit.

## **Vlerësimi i riskut (rrezikut)**

Një Plan Emergjence është si një "plan në një lojë" ose si një paketë instruksionesh që përshkruan hapat që duhen ndërmarrë përpara, gjatë dhe pas një situatë emergjente. Plani i Emergjencës parashikon të gjitha mundësitë se çfarë mund të shkojë keq me ndodhjen e situatave, parashikon kontaktet, listën me resurset në dispozicion si dhe strategjitë për të asistuar në kundërveprimin ndaj një krize (emergjence).

Në pamje të parë, një Plan Emergjence mund të duket i komplikuar, pasi ai jep shumë detaje dhe hapat që duhen ndërmarrë për parandalimin dhe reagimin ndaj një krize.

Ky Plan mbulon shumë skenarë që i adresohen situatave të ndryshme. Pavarësisht kompleksitetit të tij, Plani kur strukturohet mirë është i thjeshtë për t'u zbatuar.

Plani i Emergjencës, përgjithësisht ka 4 elementë kryesorë në strukturën e tij:

- Identifikimi i rrezikut
- Analiza e vulnerabilitetit (pikat e dobëta)
- Vlerësimi i riskut (rrezikut)
- Masat e kundërveprimit

Hartuesit e Planit të Emergjencës përdorin Identifikimin e Rrezikut dhe Analizën e Vulnerabilitetit për të bërë Vlerësimin e Riskut. Pas kësaj, Vlerësimi i Riskut përdoret si referencë për planifikimin specifik të Masave të K/veprimit.

### *Identifikimi i Rrezikut*

Janë një sërë faktorësh që mund të ndikojnë në aftësitë e ekipit për kundërveprim ndaj situatave të ndryshme si kushtet e motit, pozicioni gjeografik, shkalla e incidentit etj.

Kompanitë private që operojnë në zonën portuale hartojnë planet e tyre të kontigjencës duke adresuar kriza që mund të vijnë nga skenarë të ndryshëm.

Kështu, në zonën portuale, më evidente ka qenë incident detar me derdhje karburanti në det (akuarium). Informacioni i mëposhtëm është siguruar për të bërë Identifikimin e Rrezikut:

- Llojet e karburantit që depozitohen apo transportohen në zonën portuale;
- Vendodhja e karburantit të depozituar në sasi të mëdha si dhe rrugët e transportit të tyre. Këtu janë marrë në konsideratë çisternat me mbetje vajore që kanë firmat e licensuara për të marrë mbetjet nga anijet ;
- Kushtet ekstreme të motit që mund të shfaqen në periudha të ndryshme të vitit;
- Vendodhja e pajiseve të kundërveprimit dhe ekipi që do të angazhohet për kundërveprim.

#### *Analiza e Vulnerabilitetit*

Analiza e Vulnerabilitetit siguron informacion për resorset dhe komunitetin që mund të dëmtohet në rast incidenti apo krize. Ky informacion orienton personelin e angazhuar në kundërveprim ndaj një incidenti, që të jetë i mirëinformuar dhe të bëjë një zgjidhje të arësishme me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik, pronës dhe mjedisit.

#### *Vlerësimi i Riskut*

Planifikuesit e Kontigjencave / Emergjencave krahasojnë rrezikshmërinë dhe vulnerabilitetin në zona të ndryshme dhe vlerësojnë llojin e riskut që pozohet ndaj komunitetit. Plani i adreson këto probleme duke përcaktuar shkallën maksimale të mundshme të kontrollit të situatës, si të parandalojnë ekspozimin e komunitetit apo mjedisit dhe pronës ndaj incidenteve dhe cfarë masash duhen marrë për rehabilitimin e gjendjes.

Më poshtë po bëjmë prezent një vlerësim të riskut për një incident detar me derdhje vajore (hidrokarburet) në akuarium.

Problemet mjedisore	Aktiviteti	Aspektet që ndikojne mjedisin	Impaktet në mjedis	Mbikqyrjet
Ndotje e akuariumit të portit dhe zonës bregdetare në afërsi	Transporti i ngarkesës nga anija në kalatë dhe në rrugët tokësore	<p><i>I. Ndotja e akuariumit shkaktohet nga incidentet si:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbytja e anijes në akuariumin e Portit;</li> <li>• Përplasja e anijeve brenda akuariumit;</li> <li>• Përmbytje nga stuhitë;</li> </ul> <p><i>II. Ndotja e akuariumit mund të shkaktohet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në mënyrë të qëllimshme, për të shmangur pagesën për shërbimin e marrjes së mbetjeve vajore nga kompania e licensuar</li> </ul>	<p><i>Hidrokarburet shkaktojnë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Dëmtime në cilësinë e ujrave detare (parametrat fizikë, kimikë, dhe mikrobiologjikë)</li> <li>➤ Dëmtim të faunës dhe florës;</li> <li>➤ Dëmtim të zonës turistike me konsequenca ekonomike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Monitorim i rreptë nga autoriteti kompetent në lidhje me çështje të sigurisë së navigimit;</li> <li>➤ Konformiteti me kërkesat e Konventës Marpol 73/78;</li> <li>➤ Skema e Lajmërimit për Emergjencat; <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Trajnimi dhe Stërvitjet me operatorët e përfshirë në situata te emergjencës; <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Rritja e gadishmërisë për përballimin e kushteve ekstreme të motit që mund të ndodhin në periudha të ndryshme të vitit.</li> </ul> </li> </ul> </li> </ul>

Në përputhje me Skemën e Reagimit, bëhet identifikimi i hapave të kësaj skeme:

- Me marrjen e sinjalit të incidentit detar me derdhje vajore në akuarium, menjëherë ekipi i kundërveprimit në përbërje të Kompanisë/Kontraktorit shkon në vendin e ngjarjes dhe identifikon zonën e ndotur, sasinë e ndotjes si dhe masat për rehabilitim e zonës së ndotur.
- Vihet në veprim ekipi kundërveprues me mjetet reaguese që Kompania/Kontraktori ka në dispozicion për këtë qëllim. Nëse madhësia e incidentit është e tillë që i kalon kapacitetet reaguese që Kompania ka në dispozicion, atëherë me urdhër të përfaqësuesit të autorizuar të

A.P.D -së, do të bëhet përdorimi i pajisjeve kundërvepruese që janë asete të Autoritetit Portual (bumser, oil skimer).

- Me përfundimin e operacionit të rehabilitimit/pastrimit të zonës së ndotur në akvarium, Kompania/Kontraktori duhet të bëjë larjen e bumserit, pudrosjen dhe mbeshtjelljen e tij në barabanin si në figurën më poshtë.



janë në pronësi të Autoritetit Portual Durrës.

- Mbajtja e Proces - Verbalit mbi përballimin e situatës, ku të përshkruhet kronologjia e ngjarjes së incidentit, masat e marra, bashkëveprimi i strukturave, si dhe mjetet kundërvepruese që u përdorën për rehabilitimin e zonës së ndotur.

Ky Proces – Verbal do të firmoset nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të Kompanisë/Kontraktorit si dhe përfaqësuesit të autorizuar për Autoritetin Portual Durrës.

- Përpilimi i Informacionit apo Raportit të Ndotjes. Kjo do të varet nga përshkallëzimi i incidentit me ndotje vajore/hidrokarbure. Kur situata e krijuar e kalon nivelin e përballimit me mjetet e Kompanisë/Kontraktorit, do të hartohet Raporti i Ndotjes.

Ky Informacion apo Raport do të përpilohet nga përfaqësuesi i autorizuar i A.P.D-së dhe do të përcillet pranë Drejtorit të Përgjithshëm të A.P.D -së dhe Administratorit të Kompanisë /Kontraktorit.

- Në mënyrë që kundërveprimi ndaj derdhjeve vajore të jetë sa më efektiv në një kohë të shkurtër, hartohen Skemat e Lajmërimit në rast emergjence. Këto Skema janë hartuar nga Autoriteti Portual Durrës dhe rifreskohen herë pas here duke reflektuar ndryshimet në strukturë si dhe adresat e kontaktit.

## Detyrime të tjera



- Çdo muaj do të raportohet sipas situacionit mujor që vërteton kryerjen e shërbimit nga ana e kontraktorit. Pagesa do të bëhet për ditë pune herë sa ditë ka muaji, gjatë të tre viteve të shërbimit.
- Emërimi i personit të kontaktit në emër të kontraktorit në lidhje me problemet e zbatimit të kontratës, si për çështjet operationale ashtu dhe për performancën mjedisore dhe sociale, do t'i bëhet e ditur për Autoritetin Kontraktor nëpërmjet njoftimit zyrtar.
- Kontraktori duhet të hartojë Planin e Menaxhimit Mjedisor PMM, për minimizimin e impakteve mjedisore gjatë ushtrimit të aktivitetit. Ky Plan do të do të miratohet dhe monitorohet nga përfaqësues të Autoritetit Kontraktor.
- Hartimi i Planit Operacional për reagim ndaj derdhjeve vajore në akuarium. Ky Plan do të përgatitet nga Kompania dhe do të miratohet nga Autoriteti Kontraktor.
- Njohja me Skemën e Lajmërimit në rast incidenti detar me derdhje vajore në akuarium. Kjo Skemë është përgatitur nga Autoriteti Kontraktor dhe do të bëhet e ditur edhe për kontraktorin.
- Raportimi i Formularit mbi Performancën Mjedisore dhe Sociale të Implementimit të Kontratës. Ky Formular është përgatitur nga Autoriteti Kontraktor (A.P.D.), do të raportohet cdo muaj nga kontraktori dhe do të monitorohet nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor.
- Njohja me Rregullat e Sigurimit Teknik të stafit operacional të pastrimit të akuariumit. Këto Rregulla do të zbatohen nga stafi operacional i kontraktorit, duke u trajnuar cdo 6 muaj për këtë qëllim. Të mbahen evidenca mbi trajnimin, ku duhet të firmosin personat e trajnuar.
- Çdo 6 muaj do të bëhet trajnimi i stafit operacional të kontraktorit mbi përdorimin me efektivitet dhe në një kohë sa më të shkurter të pajisjeve të antindotjes si mbeshjtjellja dhe çmbeshjtjellja e bumserit, përdorimi i oil skimerit për ndarjen uje-vaj, përdorimin e pompave me dipersante etj.

Logo e KOMPANISE

**Tabele mbi Raportimin dhe Monitorimin  
Mjedisor & Social**

**Te dhena mbi Kompanine**

**Emri i Kompanise:** .....

**Adresa e Kompanise:**.....

**Lloji i aktivitetit:** Pastrimi i akuariumit të Autoritetit Portual Durrës

**Përfaqësuesi i autorizuar i kompanise:** .....

Vertetohet se te dhena të këtyre raportit paraqesin në mënyrë të plotë dhe korrekte operacionet gjatë periudhës së raportimit.

Nenshkrimi: .....

Date ..... /..... /2019

Titulli:

**Detaje të kontaktit:**

Telephone:.....

Mobile: .....

E-mail: [.....](mailto:.....)

**Perfaqësues të Autoritetit Portual**

Nenshkrimi: .....

Date ..... /..... /2019

Titulli.....

**Detaje të kontaktit:**

Mobile: .....

E-mail: [.....](mailto:.....)

**Periudha e Raportimit: MUAJI .....**

<b>Te Pergjithshme</b>		
Ka patur aksidente apo incidente sociale ose mjedisore qe kane shkaktuar dem, plagosje ose fatalitete, qe kane ndikuar mbi punonjesit e projektit ose komunitetin local, qe kane ndikuar mbi pronen kulturele ose kane shkaktuar pergjegjesi per kompanine?	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nese po, ju lutem, pershkruani duke perfshire detaje te veprimeve per te riparuar ose parandaluar incidentin.
A eshte projekti ne perputhje me ligjet dhe rregullat mjedisore dhe sociale?	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nese jo, jep detaje qe tregojne mos perputhjen.
Sa inspektime keni marre nga autoritetet mjedisore lokale gjate periudhes se raportimit?	Numer :	Ju lutem, jepni detaje te ketyre vizitave:
Sa inpektime keni marre nga autoritetet lokale te shendetit dhe sigurise gjate periudhes se raportimit?	Numer:	Ju lutem, jepni detaje te ketyre vizitave:
Sa inspektime keni marre nga autoritetet lokale te punes gjate periudhes se raportimit ?	Numer:	Ju lutem, jepni detaje te ketyre vizitave:
A kane rezultuar keto vizita ne penalitete, gjoba ose / plane veprimesh rregulluese?	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nese po, ju lutem pershkruaj:
A jane reduktuar, pezulluar ose mbyllur perkohesisht operacionet, per shkak te aresyeve te mjedisit, shendetit, sigurise ose te punesimit ?	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nese po, ju lutem pershkruaj:
Ju lutem, pershkruani programe qe kane lidhje me mjedisin, ose nen-projekte qe jane ndermarre gjate periudhes se raportimit: Nese nuk jane ndermarre programe te tilla, shkruaj: Nuk jane aplikuar		

## Statusi i Planit te Menaxhimit Mjedisor dhe Social

Ju lutem, jepni informacion mbi statusin e çdo pike te Planit te Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS), te hartuar nga ana e kompanise dhe miratuar nga Autoriteti Portual Durres.

Nese PMMS eshte ndryshuar gjate periudhes se raportimit, ju lutem bashkelidhni nje kopje te Planit te ri.

## Te dhena mbi Shendetin dhe Sigurine

Fatalitete <sup>1</sup>	Numer:	Koha totale e humbur nga aksidentet (perfshire dhe ato nga makinat) <sup>2</sup>	Numer:
Numri total i diteve te punes te humbura si,rezultat i incidenteve.	Numer:	Total i punetoreve ne pune gjate periudhes se raportimit :	Numer:
Incidente gjate periudhes se raportimit:	<i>Numer:</i> [Incident = total i diteve te punes te humbura/total i oreve te punuara]	Incidente gjate periudhes se meparshme te raportimit :	<i>Numer:</i> [Incident = total i diteve te punes te humbura/total i oreve te punuara]

Ju lutem, beni nje permbledhje te trajnimeve mbi shendetin dhe sigurine te kryera per personelin e kompanise gjate periudhes se raportimit:

Nese nuk jane ndermarre trajnime te tilla, shkruaj: Nuk jane aplikuar

Ju lutem, beni nje permbledhje te trajnimit mbi parandalimin dhe kunderveprimin te bere per personelin e kompanise gjate periudhes se raportimit:

Nese nuk jane ndermarre trajnime te tilla, shkruaj: Nuk jane aplikuar

Ju lutem, beni nje permbledhje te nje stervitje kunderveprimi ne situate emergjente te kryer gjate periudhes se raportimit:

Nese nuk nuk eshte aplikuar nje stervitje e tille, shkruaj: Nuk eshte aplikuar

## Menaxhimi i Burimeve Njerezore

Ka patur ndonje ndryshim ne politikat dhe kushtet e meposhtme gjate periudhes se raportimit:	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nese po, ju lutem jepni detaje:
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Politika jo diskriminuese dhe te shanseve te barabarta</li> <li>• Punesimi i te rinjve nen moshen 18</li> </ul>		

<sup>1</sup> Nese nuk e keni bere ne kete menyre, ju lutem jepni nje raport te vecante duke detajuar rrethanat e cdo fataliteti.

<sup>2</sup> Mosaftesia per te punuar te pakten nje dite te plote pune pertej dites ne te cilen ndodhi aksidenti ose semundja.

<p>vjec</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pagat (niveli i pages, pune normale dhe jashte orarit – overtime)</li> <li>• Overtime-mbi kohen normale te punes.</li> <li>• Oret e punes.</li> <li>• Mekanizmat e ankimimit per punetoret.</li> <li>• Njohjen e Unionit dhe negociatat.</li> <li>• Shendeti &amp; Siguria</li> </ul>		
Ka patur ndonje reduktim kolektiv (shkurtime) gjate periudhes se raportimit?	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nese po, ju lutem peshkruani planin e shkurtimeve, duke perfshire arsytet per shkurtime, numrin e punetoreve te perfshire, si u zgjedhen ata dhe konsultimet e ndermarra:
Ka shtesa apo shkurtime te planifikuara per fuqine punetore muajin e ardhshem?	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nese po, ju lutem peshkruani planin e shkurtimeve, duke perfshire arsytet e shkurtimeve, numrin e punetoreve te perfshire, dhe procesin e seleksionimit dhe te konsultimit:
A kane ngritur punonjesit ndonje ankimim ne lidhje me ceshtjet operationale gjate periudhes se raportimit?	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nese po, ju lutem tregoni sa ankimime, permblidhni ceshtjet e ngritura ne ankimim dhe shpjego se si kompania i adreson ato:
Ka patur ndonje greve ose mosmarreshje kolektive ne lidhje me punen dhe kushtet e punes ne periudhen e raportimit?	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nese po, ju lutem permblidhni natyren e mosmarreshjeve dhe si u zgjidhen ato.
Ka patur ndonje ceshtje ne gjykate ne lidhje me ceshtje te punes gjate periudhes se raportimit?	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nese po, ju lutem permblidhni ceshtjet e kontestuara dhe rezultatin.

### Angazhimi i Aksionereve (Operatoreve)

Sa ankimime ka marre Kompania nga anetaret e organizatave te shoqerive civile ose publike gjate periudhes se raportimit? Bej nje permblidhje te ceshtjeve te ngritura ne ankimim dhe si u zgjidhen ato:

Nese nuk ka patur ankimime te tilla, shkruaj: Nuk ka patur

Ju lutem, beni nje permblidhje te takimeve te mbajtura me anetaret e organizatave publike dhe sociale gjate periudhes se raportimit:

Nese nuk ka patur takime te tilla, shkruaj: Nuk ka patur

**SITUACIONI  
LOGO E KOMPANISË**

**Kontrata: Nr. Reference -----**

**Objekti: Pastrimi i Akuatoriumit**

**Autoriteti Kontraktor:**  
**Autoriteti Portual Durres**  
**NIPT: J 61811536 L**

**Kontraktori:**  
-----  
**NIPT: -----**

**SITUACIONI Nr \_\_\_\_\_**

**Muaji: \_\_\_\_\_**

<b>Përshkrimi i shërbimit</b>	<b>Ditë Pune</b>	<b>Cmimi për ditë pune (Lekë/ditë)</b>	<b>Cmimi Total ne muaj (Lekë)</b>
Pastrim i akuatoriumit			
Cmimi pa TVSH			
Cmimi me TVSH			

**Për**  
**Autoritetin Portual Durrës**  
**Komisioni**

**Për**  
**Kontraktorin .....**  
**Administratori**